

3.1 HIDROIZOLUES NJË KOMPONENTËSH

MONOLIT



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 5 kg/qese	54 cp/paletë 4 qese/kuti	3-4 kg/m ²	Gri



MONOLIT

Llaç hidroizolues një komponentësh me bazë çimento

KARAKTERISTIKAT

Llaç hidroizolues një komponentësh me bazë çimento i cili ofron cilësi të mira izoluese ndaj lagështisë dhe mbron betonin nga karbonizimi. Është i përshtatshëm për tu përdorur në hidroizolim të depozitave që mbajnë ujë të pijshëm, bodrumeve etj. I lehtë në aplikim dhe kosto të ulët aplikimi si dhe nuk ka efekt korroduese për betonin e përforcuar me çelik.

FUSHAT E APLIKIMIT

Hidroizolimi i sipërfaqeve prej betoni, suvasë dhe mureve nga lagështia. I përshtatshëm për hidroizolim të depozitave të ujit, bodrumeve, ambienteve nëntokësore etj. I përshtatshëm për hidroizolim të brendshëm për zonat nëntokësore, si për shembull bodrumeve, pasi i reziston presioneve të larta për shkak të lidhjes shumë të fortë që krijon me suportin.

MËNYRA E PËRGATITJES

Përgatitja e suportit

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhurat, yndyrnat dhe çdo lloj tjetër papastërtie. Nëqoftëse sipërfaqja ku aplikohet MONOLIT ka plasaritje ose të çara, fillimisht kryhet mbyllja e tyre dhe pastaj aplikohet produkti. Nëse sipërfaqja ku aplikohet ka cepa telash të dalë, ato duhet të priten nga 2 deri në 4 cm thellësi dhe pastaj vrima e krijuar mbyllet e më pas aplikohet produkti.

APLIKIMI

MONOLIT shtohet gradualisht në sasinë e kërkuar të ujit nën një përzierje të vazhdueshme derisa të formohet një masë viskoze e përshtatshme për tu aplikuar me furçë. Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë tërësisht e thatë dhe nuk duhet të ketë gjurmë lagështie. Produkti aplikohet me dy ose më shumë shtresa në varësi të mjedisit ku aplikohet. Çdo shtresë nuk duhet të jetë më shumë se 1mm e trashë për të shmangur plasaritjet dhe shtresa pasardhëse aplikohet mbi të jetë thatë plotësisht shtresa parardhëse.

PAKETIMI

MONOLIT është i ambalazhuar në thasë 25 Kg.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazh origjinal dhe mbrohet nga ngricat dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell.



TË DHËNA TEKNIKE

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Dendësia e Përzierjes	1.30 gr/cm
Djegshmëria	I padjegshëm
Ruatja	12 muaj në ambalazh original në vend të thatë
Raporti I Përzierjes	
Me spatul	
Me furçë 6 - 7 L ujë për 25 Kg MONOLIT	
7 - 8 L ujë për 25 Kg MONOLIT	
pH i Përzierjes 12	
Kohëzgjatja përzierjes	45 min
Koha e aplikimit midis 2 duarve	Pas 4 orëve në 23°C
Trashësia max	

